



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

SHKOLLA VERORE E UNIVERSITETIT TË VJENËS

Ministria e Arsimit dhe Sportit ju njofton se shkolla verore për studime ndërkombëtare dhe evropiane do të zhvillohet në Universitetin e St. Wolfgang pranë Salzburgut, në periudhën 15 korrik – 12 gusht 2023.

Programi katër javor trajton çështje të zhvillimit aktual të Evropës, Bashkimit Evropian, vendimarrjet brenda institucioneve të BE-së dhe aspekte të ndryshme të kulturës politike evropiane. Gjithashtu, ofron kurse të mësimin të gjuhës gjermane dhe bursa për ndjekjen e kursit që jepen në bazë të arritjeve akademike dhe nevojave financiare.

Tarifat e programit ndryshojnë në varësi të kurseve dhe veprimtarisë që do të ndiqen. Për përfitimin e bursës, studentët duhet të aplikojnë brenda datës 28 Shkurt 2023.

Kriteret për aplikim:

- Aplikantët duhet të jenë të paktën 18 vjeç dhe duhet të kenë përfunduar dy vjet studime në nivel kolegji ose universiteti ose të kenë përfunduar një vit në një universitet evropian përpara fillimit të programit;
- Aplikantët duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë periudhës së shkollës verore, të jenë në gjendje të marrin pjesë në numrin e kërkuar të kurseve, të zotërojnë gjuhën angleze dhe të jenë në gjendje të mirë shëndetësore. Studentët, gjuha amtare e të cilëve nuk është anglishtja, duhet të paraqesin dëshmi të aftësisë në anglisht në aplikimin e tyre.
- Aplikantët duhet të kenë parasysh gjithashtu se disa kurse mund të kenë parakushte.

Aplikimi për bursë:

Një numër i kufizuar bursash të pjeshme që variojnë nga 1,000 € në 2,600 € janë në dispozicion për pjesëmarrjen në shkollën verore të Universitetit të Vjenës.

Bursat jepen në bazë të arritjeve akademike dhe nevojave financiare. Për të marrë një bursë, studentët duhet të demonstrojnë nevojën e tyre financiare duke përshkruar gjendjen e tyre financiare dhe duke dorëzuar dokumentet përkatëse.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit për pjesëmarrjen në shkollën verore në Universitetin e Vjenës, referojuni materialit informues në website si më poshtë:
<https://shs.univie.ac.at/summer-school/>

Afati i fundit i aplikimit për bursa është 28 shkurt 2023. Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet nëpërmjet postës në adresën: Innovationszentrum Universität Wien GmbH – Sommerhochschule, Campus of the University of Vienna, Alser Strasse 4/Hof 1/Tuer 1.16 1090, Vienna, Austria